

Përshëndetje,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informim të datës 29.04.2026, nëpërmjet së cilës bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, kërkonti informacion lidhur me nëpunësen civile znj. E. D., ju bëjmë me dije se:

Së pari, lidhur me emërimin e këtij nëpunësi, nga të dhënat që administrojmë rezulton se znj. E. D. është emëruar nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë me kod 4483 në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (Rajoni Qendror), në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë - kategoria: III-a/1, me aktin nr. 2140 prot., datë 6.04.2023.

Linku i shpalljes: <https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/4010>

linku i njoftimit të fituesit : <https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/4010/4/14>.

Së dyti, lidhur me transferimin e këtij nëpunësi gjatë kohës që ka mbajtur pozicionin e sipërcituar rezulton se, në vijim të shkresës nr. 15155 prot., datë 30.08.2024 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si edhe në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, kreu I, pika 5, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 4733/1 prot., datë 12.09.2024, ka miratuar transferimin e përkohshëm për interesa të institucionit, deri në 6 muaj, për nëpunësin Znj. E. D., e cila është transferuar, nga pozicioni Drejtor i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara-Rajoni Qendror, klasa e pagës II-1, në pozicionin Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, klasa e pagës II-1.

Në vijim, në zbatim të nenit 48, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, të vendimit nr.125, datë 17.02.2016 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, Departamenti i Administratës Publike me shkresën nr. 1909 prot., datë 18.03.2025 ka njoftuar se ka përfunduar transferimi i përkohshëm për nëpunësin znj. E.D. në pozicionin Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, klasa e pagës II-1. Në përfundim të këtij afati znj. E. D. është rikthyer në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara-Rajoni Qendror, klasa e pagës II-1.

Megjithatë, nga të dhënat që ne administrojmë, nuk rezulton që znj. D. të ketë paditur institucionin tonë lidhur me këtë transferim, por ka kundërshtuar gjyqësisht aktet si më poshtë:

1. Vendimin nr. 1737/1, datë 30.03.2018, të Departamentit të Administratës Publike, për transferimin e përkohshëm 6 mujor, në interes të institucionit, nga pozicioni Përgjegjës Sektori në Sektorin e Kontrollit, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në

Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë (kategoria III-B), në pozicionin Përgjegjës Sektori në Sektorin e Financës, në Drejtorinë e Funksioneve Mbështetëse, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës.

2. Vendimin nr. 2830/165, datë 23.07.2020, të Departamentit të Administratës Publike, për transferimin e përhershëm, në përfundim të ristrukturimit të institucionit, nga pozicioni Përgjegjës Sektori në Sektorin e Kontrollit, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, kategoria e pagës III-B, në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë, në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (Rajoni Qendror), në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë (DRT Tiranë), kategoria e pagës III-b.

Së treti, lidhur me formularin e vetëdeklarimit të znj. E. D., në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Departamenti i Administratës Publike ka administruar formularin e vetëdeklarimit të dorëzuar nga znj. E. D., në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara (Rajoni Qendror), në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, me numër unik identifikimi 2313 Q 0649.

Bashkangjitur, lutemi gjeni të skanuar formularin e vetëdeklarimit.